



Building a Greener Economic Environment

Forests for Local Economic Development – Albania
Pyjet per Zhvillim Ekonomik Lokal- Shqiperi



Strengthening multi-objectives forest management approaches

Metodat e menaxhimit te Pyjeve shume funksional

(English summary in the end)

November 2018

Connecting Natural Values & People Foundation

Project implementation:



Supported by:  **Sverige**



Contents

Zhvillimi i metodave te menaxhimit te Pyjeve shume funksional perfsjire Biomasesn per energji te rinovueshme	4
1. Parathënie	4
2. Përmirësimi, zhvillimi dhe replikimi i praktikave të menaxhimit të pyjeve në kuadrin e pyllit të familjes.	5
2.1 Rezultatet dhe mesimet e nxjerra	8
3. Zhvillimi i praktikave qe lidhen me matjet e sipërfaqet provë permanente.	8
3.1 Rezultatet dhe mesimet e nxjerra	10
4. Përmirësimi i Menaxhimit të Kullotave	10
4.1 Rezultatet dhe mesimet e nxjerra	11
5. Rritet prodhimtaria nëpërmjet ndërhyrjeve silvikulturale	12
5.1 Rezultatet dhe mesimet e nxjerra	13
6. Promovohet prodhimi i biomases drusore për energji të rinovueshme	14
6.1 Rezultatet dhe mesimet e nxjerra	19
7. Zhvillimi i Agropylltarise	19
8. Aspekte të menaxhimit të pyjeve e kullotave integrohen në programin e edukimit për nxënësit.	20
8.1 Rezultatet dhe mesimet e nxjerra	24
9. ENGLISH SUMMARY	25

Shkurtime

CNVP	Fondacioni Bashkojme Vlerat e Natyres me Njerezit
NjA	Njesi Administrative
NjQV	Njesi e Qeverisjes Vendore
SHPPKK	Shoqata e Perdoriesve te Pyjeve e Kullotave Komunale

I. Parathënie

Shqipëria ka një sipërfaqe pyjore prej 1,052,252 ha nga të cilat 379,396 ha janë pyje të lartë, 295,440 ha janë pyje të ulët (cungishte) dhe 377,416 ha shkurre. Pyjet në Shqipëri janë dëmtuar dhe shkatërruar shumë gjatë 30 viteve të fundit për shkak të mbishfrytëzimit, prerjeve të paligjëshme por edhe ndryshimit të sistemit politik dhe ekonomik që krijoi mundësi për të përfituar nga tregëtimi i materialit drusor. Sot, tregu vendas është i pamundur për të plotësuar nevojat me biomasë drusore. Nga ana tjetër shumë përdorues kanë bërë përpjekje për të mbrojtur pyjet në afërsi të fshatrave dhe shtëpive të tyre, pyje të cilat ata i kanë përdorur tradicionalisht dhe i konsiderojnë si pronën e tyre. Për përmirësimin e situatës së pyjeve në vitet 90 filloi procesi i krijimit të pyjeve komunale dhe mbështetja e organizatave nderkombëtare për përdorim tradicional të tyre. Me vendimet e fundit pyjet komunalë kanë kaluar në pronësi të bashkive (pas vitit 2015, sipas reformes territoriale). Nga ana tjetër reforma në pyje konsistoi me shkrirjen e shërbimit pyjor duke krijuar struktura të pyjeve pranë cdo bashkie. Masat e reja të përcaktuara në legjislacionin e pyjeve ju dha me shume autoritet dhe përgjegjësi Bashkive. Ky proces krijoi mundësi më të mirë për përdorimin tradicional prej familjeve rurale të cilat e kanë përdorur tradicionalisht sipërfaqen pyjore. Por nga ana tjetër Shqipëria ka një ligj moratoriumi që ndalon aktivitetet e shfrytëzimit të pyjeve për një periudhë 10 vjecare me qëllim që të përmirësojë situatën. Sidoqoftë situata nuk mund të përmirësohet vetëm me masa kufizuese në qoftë se ato nuk shoqërohen me ndërhyrje të tjera për të përmirësuar pyjet duke ulur presionin ndaj tyre nëpërmjet, nxitjes së alternativave të tjera për ngrohje dhe reformave në mënyrën e menaxhimit të pyjeve prej komunitetit. Simbas Strategjisë Kombëtare të Energjisë drutë e zjarrit në vitin 1990 kontribonin rreth 27% në totalin e konsumit të energjisë. Sot, biomasë drusore kontribon në 10% të konsumit total të energjisë me synim që në

vitin 2020 të mbulojë rreth 7.1% të konsumit total të energjisë. Kjo ulje e konsumit të energjisë nga biomasa ka ulur deri diku presionin ndaj pyjeve, por përsëri sasia e druve të zjarrit që priten nga pyjet është disa herë më e lartë se rritja mesatare vjetore e pyjeve e cila ndikon negativisht në zhvillimin normal të pyjeve. Nga ana tjetër vihet re një tendencë për të rritur eficiencën e energjisë për ngrohje kryesisht në godinat private si dhe përdorimi i sistemeve për ngrohje nga energjia e rinovueshme. Prodhimtaria dhe përdorimi i peletit për ngrohje është rritur gjatë viteve të fundit si dhe janë bërë përpjekje për të ngritur sisteme ngrohje me pelet edhe në qendra dhe institucione publike. Projekti FLED testoi qasje të vjeljes të qëndrueshme duke adresuar kërkesat për material drusor, të cilat lidhen fort me familjet rurale që kanë në pronësi ose në përdorim sipërfaqe pyjore dhe që kanë krijuar ose duan të krijojnë pyllin e familjes si një praktikë e menaxhimit të pyjeve për të plotësuar nevojat e familjeve rurale. Kjo praktikë e menaxhimit të pyjeve u mbështet nëpërmjet trainimeve, metodave të menaxhimit dhe shkëmbimit të eksperiencave në terren.

Projekti FLED mbështeti gjithashtu komunitetin të përmirësoje menaxhimin e pyjeve përfshirë dhe mbjelljen e llojeve me rritje të shpejtë duke krijuar sisteme agro pylltarie që sigurojnë biomasë drusore brenda një periudhe të shkurtër. Projekti zhvilloi dhe ringjalli një traditë të mëparëshme duke mbjellë plepa anës rrugëve, kanaleve, tokave bujqësore etj. I mbështetur në ekpserienat e mëparëshme në krijim e brezave pyjore kundër erërave.

Mjaft i suksesshëm ishte edhe programi i edukimit i cili u bazua kryesisht në nivelin e nxënësve të klasave të 8 dhe 9. Ky program u bazua mbi një manual të përgatitur nga CNVP dhe marëveshjet me Drejtorive Rajonale të Arsimit. Ai pati për qëllim t'ju japë nxënësve dhe mësuesve njohuri mbi zhvillimin e qëndrueshëm, rëndësinë e pyjeve, biodiversitetin, eko-turizmin dhe habitatet pyjore. Disa aktivitete edukimi u shoqëruan me mbjellje fidanash për rreth shkollave duke gjelbëruar ambientin e shkollave dhe duke krijuar një lidhje midis teorisë dhe praktikës. Ky program edukimi u lidh me programin e biologjisë dhe mjedisit të shkollave 9 vjeçare.

2. Përmirësimi, zhvillimi dhe replikimi i praktikave të menaxhimit të pyjeve në kuadrin e pyllit të familjes.

Të gjitha pyjet pavarësisht pronësisë dhe zotërimit të tyre krijojnë ujra të pastra, habitate për jetën e egër, ajër të pastër, ambient clodhës, pushues e edukues; ato përmirësojnë klimën dhe prodhojnë material drusor për përdorim të përditëshëm. Por pylli i familjes në Shqipëri ka rëndësi të

vecantë sepse tek ne ka një numer të konsiderueshëm familjesh që jetojnë në zonat rurale dhe duke krijuar dhe mirëadministruar pyllin e familjes krijojnë mundësi për përmirësimin e gjëndjes së pyjeve. Në qoftë se ne duam të përmirësojmë situatën e pyjeve duhet që pylli i familjes të jetë prioritet për t'u siguruar familjeve rurale materialin drusor për ngrohje.



Pse pylli i familjes. Pylli i familjes është një praktikë menaxhimi i pyllit që zhvillohet në sipërfaqe të vogla nga familjet apo grup familjesh. Duke krijuar dhe zhvilluar pyllin e familjes ne përmirësojmë pyjet, mbrojmë tokat nga përmbytjet dhe erozioni, përmirësojmë pastërtinë e ujrave, jetën e egër dhe përmirësojmë cilësinë e jetës së vetë banorëve. FLED mbështeti këtë model duke e zhvilluar më tej nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve të përdoruesve/pronarëve dhe duke edukuar brezin e ri se si duhet të mendojnë për pyjet dhe mjedisin. Nëpërmjet këtij modeli u inkurajua menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe u nxitën institucionet shtetërore të kuptojnë rëndësinë e përmirësimit të politikave duke mbështetur pyllin e familjes. Gjatë zbatimit të projektit FLED pylli i familjes u promovua më tej duke kombinuar dhe krijuar edhe sipërfaqe provë permanente për të zhvilluar kapacitetet dhe për të fituar njohuri të mëtejshme në prodhimtarinë e llojeve të ndryshme pyjore.



CNVP mbështeti përdoruesit/pronarët e pyjeve të zhvillojnë menaxhimin e pyllit të familjes duke ftuar drejtues të bashkive dhe kryetarë të fshatrave pilot për të shkëmbyer eksperiencat dhe për të diskutuar për mësimet e nxjerra në lidhje me zhvillimin e pyllit të familjes dhe mundësitë e replikimit të tyre. Ky model është përdorur gjithashtu si vend demonstrimi për rritje kapacitetesh si trajnime, zhvillim modulesh dhe shkëmbim njohurish e mësimesh të nxjerra. CNVP ka mbështetur këtë model që me fillimin e projektit për të përmirësuar, zhvilluar dhe replikuar praktika të përshtatëshme të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve. Aktorët kryesorë kanë vlerësuar modelin e pyllit të familjes dhe kanë shkëmbyer ide dhe eksperiencat si dhe kanë diskutuar mundësitë për replikim të këtij modeli në zona dhe fshatra të tjerë. Projekti FLED nxiti përfshirjen e aktorëve kryesorë në shkëmbimin e njohurive dhe vlerësimin e pyllit të familjes.

Sot, shumë pyje të degraduar në dekadat e kaluara janë kthyer në pyje me prodhimtari si rezultat i kujdesit që tregojnë familjet për pyjet që i kinsiderojnë te vetat dhe ku ato sigurojnë dru zjarri dhe produkte të tjera pyjore. Për të arritur objektivat e tyre primare për sigurimin e druve të zjarrit, familjet përdorën shumë teknika duke kryer përmirësim të pyjeve nëpërmjet heqjes herë pas here të drurëve të tharë ose në tharje e sipër, ata të shtrembër dhe të nënshtruar. Nga ana tjetër familjet janë të ndërgjegjshme në ndryshimet pozitive të ndodhura në ripërtëritjen e pyjeve, prodhimtarinë, menaxhimin e ujrave dhe përmirësimin i pejsazhit.



Modele të ndryshme të pyllit të familjes me përbërje të ndryshme pyjesh u krijuan në rajone të ndryshme të vendit të cilat sot janë edhe sipërfaqe demonstruese si për përdoruesit/pronarët e pyjeve ashtu dhe për specialistët e pyjeve. Por, familjet rurale që përdorin ose kanë në pronësi pyllin e familjes kërkojnë më shumë të drejta për menaxhimin e pyllit të familjes. Diskutime dhe debate janë bërë midis institucioneve dhe aktorëve kryesorë si të

përmirësohen politikat pyjore dhe legjislacioni në mbështetje të përdoruesve të pyjeve. Shpesh herë përdoruesit ngrenë pyetjet: do i zotëroj unë pyjet që po i ruaj dhe kujdesem kur ata do të arrijnë moshën për tu prerë? Do të mund ta shes materialin drusor që prodhohet më shumë se kërkesat familjare nga menaxhimi i qëndrueshëm i pyllit të familjes? Do të mund të krijohet një system i certifikimit të pyllit të familjes që të realizojë standartet e zhvillimit të qëndrueshme dhe prodhimtarisë së shumëfishtë?

Rezultatet:

Rriten njohuritë e përdoruesve për të menaxhuar pyllin e familjes. Përfshihen aktorë të ndryshëm në shkëmbimin e njohurive dhe eksperiencave, vlerësimit dhe mundësive për replikim të pyllit të familjes. Përmirësohet besimi midis aktorëve për të punuar sëbashku për menaxhimin e pyllit të familjes. Rritet interesi i përdoruesve të tjerë për të zhvilluar pyllin e familjes.

Mësimet e nxjerra:

Përdoruesit nuk kanë kapacitete për të zhvilluar pyllin e familjes mbështetur në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve. Sipërfaqet provë të përhershme ndihojnë për të analizuar zhvillimin e pyllit të familjes duke demonstruar përfitimet që vijnë nga ky lloj menaxhimi i pyjeve. E drejta e përdorimit është e kufizuar duke i bërë përdoruesit të ndihen të pasigurtë. Rregullat e administrimit të pyjeve pengojnë marrjen e vendimeve të shpejta nga ana e vetë përdoruesve. Pylli i familjes duhet të përfshihet në legjislacionin e pyjeve duke lehtësuar të gjitha procedurat për administrimin dhe menaxhimin e tyre. Përfitohen njohuri të mëtejshme për prodhimtarinë e llojeve të ndryshme pyjore.

3. Zhvillimi i praktikave që lidhen me matjet e sipërfaqet provë permanente.

FLED mbështeti, zhvilloi, testoi dhe monitoroi modelin e pyllit të familjes nëpërmjet ngritjes së sipërfaqeve provë permanente. Krahas sipërfaqeve provë të mëparëshme, në bashkëpunim me përdoruesit e pyjeve u ngrit një rrjet i gjerë i sipërfaqeve provë të përhershme të reja për të monitoruar kushtet pyjore dhe rezultatet e ndërhyrjeve/trajtimeve në pyje. U ngritën në

total më shumë se njëqind e njëzet sipërfaqe prove të reja, të cilat sëbashku me të vjetrat u matën dhe u monitoruan rregullisht për të dhënë dëshmi dhe informacion mbi modelet e pyllit të familjes. Të dhenat e grumbulluara u përdorën për të zhvilluar më tej metodologjinë dhe modelet pyjore me drejtim shumë objektivash bazuar në nevojat e përdoruesve të pyjeve. Projekti përdori këto eksperiencë për mësim, rritje kapacitetesh të SHPPKK, Federatave të tyre, Shërbimit këshillimor duke zhvilluar këtë model pyjor dhe mbështeti praktika për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve të fokusuar në pyjet e komunitetit. Për përpunimin e të dhënave u ndërtua baza e të dhënave për të llogaritur biomasën dhe sekuestrimin e karbonit. Të dhenat e grumbulluara nga matjet dhe monitorimi i sipërfaqeve provë janë përpunuar dhe janë hedhur në bazën e të dhënave online e cila është përmirësuar dhe përditësuar.



Sipërfaqe provë janë përzgjedhur në pyjet e Bashkisë, pyje private ose përdorues tradicional si dhe në zonat e mbrojtura dhe parqet kombëtare. Vendodhja e sipërfaqeve provë është përcaktuar me saktësi sipas koordinatave të matura me GPS mbështetur në një rrjet koordinatash permanent cdo 200m. Sipërfaqet provë janë dokumentuar dhe janë rimatur për të vlerësuar ndryshimet si numri i drurëve, rritja vjetore, tharjet, prerjet e paligjësme, ripërtëritjen, etj.

Baza e të dhënave të sipërfaqeve provë të përherëshme që është ngritur online mund të përdoret nga shumë institute dhe organizata duke përfshirë Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, strukturat pyjore pranë bashkive, Federatat e SHPPKK, Universitetet, shkolla e mesme pyjore etj. të cilët kanë mundësi të përdorin këtë informacion dhe të gjenerojnë raporte për nevojat e tyre. Ata mund të monitorojnë më tej zhvillimin e pyjeve, rritjen, biomasën dhe sekuestrimin e karbonit sipas grumbujve pyjore dhe pronësive të ndryshme. Këto sipërfaqe provë janë përdorur dhe përdoren edhe si sipërfaqe demonstrimi dhe rritje kapacitetesh.

Rezultatet:

Ngrihen kapacitetet e përdoruesve/privatëve të pyjeve për të monitoruar zhvillimin e pyjeve dhe prodhimtaria e grumbujve pyjore.

Përmirësohet baza e të dhënave për të monitoruar rritjen dhe prodhimtarinë e pyjeve

Krijohen modele demonstrimi për të krahasuar zhvillimin dhe prodhimtarinë që ka pylli i familjes krahasuar me pyjet që janë në pronësi të bashkive.

Përmirësohen kapacitetet dhe njohuritë e fermerëve për të analizuar rritjen e vlerës së pyllit të tyre ndër vite.

Institucionet dhe organizatat kanë akses dhe i përdorin për qëllime shkencore, mësimore dhe edukuese për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve të komunitetit.

Mësimet e nxjerra:

SHPPKK-ve ju mungojnë pajisjet elementare për të kryer matjen dhe rimatjen e sipërfaqeve prove duke ulur interesin e përdoruesve/pronarëve të pyllit të familjes.

Numri i sipërfaqeve provë të ngritura është ende i vogël dhe nuk krijon mundësi për analiza më të thelluara.

Mbështetja për monitorimin e sipërfaqeve prove duhet të vazhdojë nga ana e CNVP dhe organizatave dhe institucioneve të tjera.

4. Përmirësimi i Menaxhimit të Kullotave

Kullotat luajnë një rol kyç në zhvillimin rural në jug të Shqipërisë. Ato prodhojnë ushqim për blektorinë, zbukurojnë pejsazhin, mbrojnë tokën nga erozioni dhe krijojnë habitate për jetën e egër. Fermerët në këto zona sigurojnë të ardhura nga kullotat nëpërmjet produkteve blektorale të nevojshme për jetesën e tyre. Sidoqoftë, praktikat e kullotjes kanë qenë të pakontrolluara dhe shpesh kanë çuar në degradimin e tyre megjithëse të ardhurat që krijohen nga grumbullimi i tarifave në kullota krijojnë mundësinë për përmirësimin e tyre. CNVP mbështet zonat pilot në jug të Shqipërisë për të përmirësuar menaxhimin e kullotave nëpërmjet promovimit të përmirësimit të menaxhimit të kullotave. U përmirësuan informacioni dhe njohuritë mbi: klasifikimin dhe përshkrimin e kullotave, vlerësimin e biomases së kullotave dhe kapacitetit mbajtës së tyre, përmirësimi i cilësisë së kullotave dhe ndërtimi i lërave me ujë dhe

koritave për të siguruar ujë të pijshëm për blektorinë. Një pilot u mbështetën për të zhvilluar modele të menaxhimit të qëndrueshëm të kullotave bazuar në: kapaciteti mbajtës i kullotave; shfrytëzimi dhe kullotja racionale; kriteret e kullotjes dhe këshilla praktike; masa për infrastrukturën; parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri të kullotave përfshirë edhe ndërgjegjësimin e popullsisë lokale dhe barinjve. Përdoruesit e kullotave ndërmorën masa për përmirësimin e kullotave dhe për të zhvilluar modele të menaxhimit të qëndrueshëm të kullotave. Nga ana tjetër janë ftuar specialist të fushës, stafi i Njësisë Administrative, Federata Rajonale e Pyjeve dhe Kullotave, Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve Kullotave si dhe blektorë për të ndarë eksperiencat në menaxhimin e kullotave, vecanërisht në përmirësimin e kapacitetit mbajtës të kullotave nëpërmjet ndërtimit të infrastrukturës së nevojshme. Për të rritur kapacitetet janë organizuar shkëmbime eksperiencash dhe trainime në terren. Stafi i bashkive përmirësoi sistemin e grumbullimit të tarifave prej kullotave. Ri-organizimi i strukturave të pyjeve e kullotave brenda bashkive ka kijuar gjithashtu më shumë mundësi për grumbullimin e tarifave dhe taksave në kullota. U rritën të ardhurat tarifave në kullota duke krijuar një sistem për grumbullimin e tarifave dhe taksave nga përdorimi i kullotave dhe ri-investimi i këtyre të ardhurave në përmirësimin e kullotave.

CNVP do të vazhdojë përfshirjen e aktorëve kryesorë në diskutime, shkëmbim eksperiencash, dhe zhvillimin e njohurive për menaxhimin e kullotave nëpërmjet trainimeve, takimeve, seminareve dhe shkëmbim eksperiencash.



Rezultatet:

Mbi 30 përdorues nga NJA pilot lidhin kontrata me Bashkinë për përdorimin e kullotave.

Përmirësohet informacioni për vlerësimin e biomases së kullotave dhe kapacitetit mbajtës të tyre

Përmirësohet cilësia e kullotave dhe infrastruktura e nevojshme.

Rriten të ardhurat e siguruar nga grumbullimi i tarifave dhe ngrihet sistemi i ri-investimit të tyre për përmirësimin e kullotave.

Mësimet e nxjerra:

Megjithse janë bërë disa kontrata për përdorimin e kullotave numri i tyre duhet të rritet dhe të shtrihet në vazhdimësi.

Sistemi i i grumbullimit të tarifave dhe ri-investimi i tyre në përmirësimin e kullotave duhet përmirësohet më tej.

Stafi i bashkive, SHPPKK dhe blektorët kanë nevojë për rritje të mëtejshme të kapaciteteve.

5. Rritet prodhimtaria nëpërmjet ndërhyrjeve silvikulturale

FLED ka zhvilluar aktivitete që mbështesin grupet e përdoruesve në rallime, krasitje, mbjellje dhe zhvillimin e agropylltarisë me qëllim që të rritet prodhimtaria nga sipërfaqet dhe kulturat pyjore. Këto aktivitete kanë ndihmuar përdoruesit e pyjeve për të siguruar përfitime nga ndërhyrjet dhe punimet silvikulturale. Rallimi si teknikë silvikulturale përmirëson cilësinë e grumbullit pyjor dhe rrit prodhimtarinë e tij për material drusor. Shpesh herë është më efektive të ndihmohet zhvillimin e llojeve pyjore të dëshiruara se sa të bësh mbjellje me drurë pyjorë. Pikërisht për këtë, projekti zhvilloi modelin e ndërhyrjeve silvikulturale për përmirësimin e sipërfaqeve me lajthi në Sllövë, Dibër; krasitjet dhe shartimet në lajthi si dhe shëgë në rajonin e Shkodrës. Nga ana tjetër u zhvilluan metoda silvikulturale të pyjeve në rajonet Elbasan



dhe Korçë, nëpërmjet të cilave u siguran dru zjarri për nevojat e komunitetit. Shumica a pyjeve të Bashkive dhe pyllit të familjeve janë pyje të rinj dhe kanë nevojë për ndërhyrje silvikulturale për të rritur prodhimtarinë e tyre. Rallimet kanë nxitur rritjen dhe prodhimtarinë e drurëve të dëshiruar nëpërmjet heqjes së drurëve të shtrembër, kalbur, në tharje e sipër ose të atyre që gjenden shumë afër dhe pengojnë zhvillimin e njëra tjetrës. Drurët e ngeleur pas rallimit kanë pasur zhvillim të shpejtë dhe prodhimtari të kënaqëshme. Ky aktivitet ka qenë një prioritet i përdoruesve të pyllit duke dëshiruar të përmirësojnë cilësinë dhe vlerat e materialit drusor por gjithashtu duke

siguruar dru zjarri dhe materiale të tjera drusore për nevojat e tyre. Përdoruesit e pyllit nuk kishin kapacitete për të kryer këto ndërhyrje silvikulturale dhe CNVP i trajnoi ata për të siguruar material drusor nëpërmjet ndërhyrjeve silvikulturale dhe duke rritur prodhimtarinë e tyre.



Ky model u zhvillua dhe zbatua në Parqet Kombëtare “Prespe” në Bashkinë Pustec, Korçë, dhe “Shebenik Jabllanice” në Bashkinë Librazhd, Elbasan. Nevojat për dru zjarri në këto zona janë të larta si kudo në zonat malore. Më parë sigurimi i druve të zjarrit në këto zona ishte bërë në mënyra të corganizuar nga secila familje duke krijuar problem si për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve ashtu edhe për vete jetën e tyre. CNVP mbështeti komunitetet e këtyre zonave me projekte për rallimin dhe krijoi bashkëpunim midis stafit të Parqeve kombëtare dhe përdoruesve të pyllit për sigurimin e druve të zjarrit për nevojat e komunitetit lokal nëpërmjet përmirësimit të pyjeve. CNVP po e zhvillon këtë model dhe po e shtrin e replikon edhe në fshatra dhe zona të tjera.

Rezultatet:

Identifikohen dhe mbështeten praktikatat dhe eksperiencat për zbatimin e planit të menaxhimit.

Rritet interesi dhe përmirësohen njohuritë e përdoruesve të pyjeve për të rritur prodhimtarinë e pyjeve nëpërmjet ndërhyrjeve silvikulturale.

Rriten njohuritë për të përgatitur drutë e zjarrit në mënyra të qëndrueshme.

Rritet besimi i aktorëve kryesorë për të punuar sëbashku në zbatimin e planeve të menaxhimit dhe sigurimi i druve të zjarrit.

Përmirëohen praktikatat për zbatimin e planeve të menaxhimit në bashkëpunim me komunitetin.

Mësimet e nxjerra:

Kur besimi dhe bashkëpunimi midis institucioneve dhe komunitetit është i mirë krijohen mundësi për të dy palët për të përfituar nga zbatimi i planeve të menaxhimit.

Shumica e pyjeve të dushkut janë pyje të rinj me shumë numer drurësh të cilat nëpërmjet ndërhyrjeve silvikulturale sigurojnë dru zjarri për nevojat e komunitetit.

Shumë planeve të menaxhimit ju ka kaluar afati dhe rregulloret nuk lejojnë të kryhet ndërhyrje pa u miratuar planet e rinj të menaxhimit.

Shumë bashki nuk kanë mundësi financiare për të përgatitur planet e menaxhimit.

Është mirë që projektet e përgatitura për ndërhyrje silvikulturale të lejohen për tu zbatuar pavarësisht se ka kaluar afati i planeve të menaxhimit.

Trajnimet dhe aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve janë të nevojshme dhe duhet të vazhdojnë më tej për zbatimin e planeve të menaxhimit dhe përgatitjen e druve të zjarrit.

6. Promovohet prodhimi i biomasës drusore për energji të rinovueshme

Materiali drusor i pyjeve në Shqipëri përdoret kryesisht për dru zjarri. Duke qenë se kërkesat për dru zjarri janë shumë më të larta se mundësitë e pyjeve është e nevojshme të promovohen burime të energjisë së rinovueshme dhe shtimit të llojeve me rritje të shpejtë. FLED, për të rritur vlerat e zinxhirit të biomasës për energji të rinovueshme, mbështeti zhvillimin e modeleve të energjisë së rinovueshme si dhe prodhimin e biomasës drusore nga lloje me rritje të shpejtë në sipërfaqe të vogëla.



Në Shqipëri ka disa kompani që prodhojnë pelet që nga viti 2008. Disa nga kompanitë e peletit janë kompani që shfrytëzojnë dhe përpunojnë materialin drusor duke përdorur mbetjet drusore dhe tallashin për prodhimin e peletit. Në kuadrin e zhvillimit të energjisë së rinovueshme nga biomasa drusore,

CNVP bashkëpunoi me Fabrikën e peletit “Redi Pellet” në Maliq, Korçë për të kuptuar më mirë: si kompania e prodhon peletin; prej nga e merr lëndën e parë për prodhimin e peletit; dhe cilat janë mundësitë për bashkëpunim për zhvillimin më tej të biomasës drusore për energji të rinovueshme.



CNVP nga viti 2014 ka bashkëpunuar me Redi Pellet për të përmirësuar zinxhirin e vlerave si dhe për të rritur kapacitetet dhe ndërgjegjësimin e aktorëve të përfshirë në këtë proces. Shqetësimi i kompanisë ka qenë ligji i moratoriumit që ndalon shfrytëzimin e pyjeve duke ulur mbetjet drusorë që mund të përdoren si lëndë e parë për prodhim peleti. Politikat e reja pyjore dhe ligji i moratoriumit kanë efekt mbi kompanitë e prodhimit të peletit sepse ato ndejnë mungesën e lëndës së parë nga mbetjet e drurit dhe tallashit. Pikërisht për këtë shtimi i plantacioneve me lloje me rritje të shpejtë është një mundësi për të siguruar lëndën e parë në periudhë sa më të shkurtër. Më shumë se 60,000 fidana plepi janë mbjellë nga fillimi i projektit FLED në fushën e Korçës në afërsi të fabrikës së peletit dhe pritet që kjo shifër të shkojë në 100,000 fidana këtë vit ose vitin në vazhdim. CNVP ka punuar të krijojë lidhje midis fabrikës së peletit dhe fermerëve që kanë mbjellë ose dëshirojnë të mbjellin plep duke siguruar mundësi për shitjen e materialit drusor.

Ky model u replikua dhe zhvillua në zona të ndryshme në shkallë vendi duke mbjellë lloje me rritje të shpejtë si plep, shelig, dhe paulonia për të prodhuar biomasë drusore. Nëpërmjet projektit u monitorua ecuria e fidanave të mbjellë, u bënë matje dhe përlllogaritje e rritjes, janë ndarë eksperiencat, është diskutuar për shtrirjen dhe mundësitë e përmirësimit të llojeve me rritje të shpejtë dhe është parë se si mund të replikohet në pjesë të tjera të vendit. Gjithë aktorët janë të mendimit që në një vend ku cilesia dhe sasia e materialit drusor po bie ndjeshëm nga praktika shfrytëzimi të paqëndrueshme, mbjellja me lloje me rritje të shpejtë do të ketë efekt pozitiv në prodhimtarinë e pyjeve duke mundësuar prodhim të materialit drusor brenda një periudhe të shkurtër. Në të njëjtën kohë këto sipërfaqe të mbjella me plep kanë leverdi mjedisore dhe kontribuojnë në zvogëlimin e CO₂. Bazuar në monitorimet

dhe llogaritjet e matjeve të kryera gjatë 4 viteve rezultojnë se mbjelljet me plep kanë zhvillim shumë të mirë. Modeli i ngritur në fushën e Korcës ka rritje mesatare vjetore 6.8 m³/ha dhe prodhimtari 74 m³/ha ndërkohë që mosha e plepit është 7-8 vjeçare.

Ky model u bazua në eksperiencat e mëparëshme të përdorura në fushën e Korcës duke krijuar brezat pyjore mbrojtës, mbjelljen e plepit në shtratet e lumenjve, anës kanaleve, rrugëve auto etj. FLED identifikoi dhe zhvilloi këto eksperiencat për prodhimin e biomasës drusore dhe zhvilloi më tej investimet, eksperiencat dhe programet e mëparëshme. Mbjellja me lloje me rritje të shpejtë e këtyre sipërfaqeve si dhe atyre tokave që përmbysen nga reshjet duket një alternativë premtuese për prodhim biomase në zonat fushore përfshirë dhe prodhimin e biomasës drusore për energji të rinovueshme. Si një eksperiencë unike ishte e rëndësishme ndarja e njohurive dhe mësimëve të nxjerra.

Por për të zhvilluar më tej këtë aktivitet është e nevojshme sigurimi i materialit mbjellës dhe CNVP mbështeti zhvillimin e fidanishteve pranë bashkive për të prodhuar fidana me lloje të shpejtë të cilat dikur kanë ekzistuar pranë drejtorive të shërbimit pyjor. Modeli i fidanishtes pyjore u ngrit në Bashkinë



Maliq dhe u mbështet nga FLED për të prodhuar fidana plepi, shelgu etj. Bashkia Maliq e këshilluar CNVP ka projektuar të mbjellë lloje me rritje të shpejtë përgjatë lumit Devoll dhe degëve të tij duke përdorur rotacion të shkurtër (5-7 vjet) për prodhim dru zjarri për të plotësuar nevojat e shkollave dhe enteve të tjera publike. Nga ana tjetër, një pjesë e fidanave të fidanishtes do t'u shpërndahet fermerëve të interesuar për të mbjellë lloje me rritje të shpejtë anës tokave bujqësore përgjatë lumenjve e përrrenjëve, kanaleve, rrugëve etj. CNVP po e mbështet këtë model dhe po shikon mundësinë për ta replikuar në Bashki të tjera të vendit.

Nga ana tjetër CNVP monitoroi me kujdes plantacionet me Paulonia në Gjirokaster, Diber e rajone të tjera. Nga matjet rezulton qe Paulonia ka një rritje prej 12.3m³/ha ne moshën 4-5 vjecare. Zhvillimi i saj do të vazhdojë të monitorohet për të parë ecurinë e saj në vitet në vazhdim.



Sidoqoftë Paulonia nuk është e njohur si plepi në vendin tonë dhe CNVP sëbashku me aktorët kyc po i monitoron me kujdes këto plantacione me Paulonia për cdo efekt negativ, vecanërisht ndaj varfërimit të tokës dhe ujit. Paulonia ka rritje shumë të shpejtë por varfëron tokën dhe ndikon në burimet ujore. Nga ana tjetër ka një sistem rrënjor që shtrihet shumë dhe bëhet i vështirë për ta shkukur pas mbjelljes. Druri i Paulonias është shumë i butë dhe jo i përshtatshëm për dru zjarri por mund të përdoret si biomasë në industrinë e peletit.


Për të mësuar më mirë dhe për të pasur njohuri mbi zinxhirin e vleravë të biomasës së drurit CNVP krye studim mbi zinxhirin e vlerave të biomasës drusore, përfshirë edhe atë për energji të rinovueshme. Paraprakisht u pergatit nje metodologji e cila përfshiu vizita në terren në katër rajone: Diber, Korca, Shkoder and Kukes ku u kryen intervista me aktorë të ndryshëm për të analizuar zinxhirin e vlerave të druve të zjarrit dhe peletit në lidhje me: politikat, mbështetjen e organizatave, prodhimin, tregëtimin dhe konsumin. Në lidhjen me drutë e zjarrit studimi evidentoi 4 zinxhirë të ndryshëm për drutë e zjarrit:

1. Zinxhiri i përdorimit të druve të zjarrit për konsum vetjak, i cili fillon me fermerët qe pergatisin drutë e zjarrit në pyllin e familjes / pyllin e përbashkët ose atë bashkiak. Ata i presin dhe thajnë drutë e zjarrit vetë.
2. Zinxhiri i druve të zjarrit informal i cili megjithëse informal konsiderohet si zinxhiri me më shumë vlerë. Ata që presin pyjet ilegalisht pergatisin drutë e zjarrit në të gjithë pyjet pa u kujdesur për pyllin dhe burimet e tij dhe e shesin materialin drusor tek tregëtarët ose direkt te konsumatorët

familjarë në qytet. Vlerësohet se rreth 80% e druve të zjarrit kryhet në këtë mënyrë.

3. Zinxhiri i druve të zjarrit nga kompanitë private të cilat kanë një kontratë me koncesion me shtetin. Kompanitë pergatisin drutë e zjarrit dhe i shesin tek konsumatorët privatë ose publike nëpërmjet tregut. Ligji i moratoriumit ka pasur efekt edhe mbi kompanitë e shfrytëzimit të pyjeve.

4. Zinxhiri i druve të zjarrit të bashkive të cilat sipas ligjit të moratoriumit janë direkt përgjegjës për përgatitjen e druve të zjarrit për furnizimin me dru zjarri të popullatës brenda territorit të tyre. Në fakt ky zinxhir nuk ka funksionuar deri tani dhe shumë bashki e shohin me skepticizem mundësinë e frunizimit me dru zjarri të popullatës.



Zinxhiri i vlerave të peletit është i përqëndruar kryesisht në kompanitë e peletit. Shumica e kompanive e marrin materialin e parë nga mbetjet e kompanive të përpunimit të lëndës drusore. Një pjesë të lëndës së parë e marrin nga jashtë. Tregu i peletit është kryesisht tregu i jashtëm por një pjesë e kompanive kanë kontrata edhe me institucione publike si shkolla, por edhe në familje në qyteti, megjithëse numri i atyre që përdorin pellet është i vogël ai po vjen duke u rritur gradualisht.

Rezultatet:

Identifikohen dhe mbështeten eksperiencat/praktikat e mëparëshme për mbjelljet me plep.

Rriten mundësitë e bashkëpunimit për zhvillimin më tej të biomasës drusore për energji të rinovueshme.

Rritet sipërfaqja e mbjellë me lloje me rritje të shpejtë dhe prodhimtaria e biomasës për energji të rinovueshme.

Rritet interesi i fermerëve për të mbjellë lloje me rritje të shpejtë duke krijuar plantacione në sipërfaqe të vogla.

Përmirësohet bashkëpunimi midis sektorit privat dhe fermerëve për biomasën drusore.

Mësimet e nxjerra:

Zhvillimi i energjisë së rinovueshme nga biomasa është një mundësi për të ulur presionin ndaj prerjeve të pyjeve.

Mbështetja në eksperiencat e mëparëshme është shumë e rëndësishme për zhvillimin e prodhimitarisë së llojeve me rritje të shpejtë për biomasë drusore. Kompanitë private dhe komuniteti nuk kanë njohuri dhe kapacitete për të shtuar dhe mbjellë lloje me rritje të shpejtë.

Moratoriumi i pyjeve krijon kufizime por nga ana tjetër i nxit fermerët dhe kompanitë private të mendojnë për mbjelljen e llojeve me rritje të shpejtë.

Skemat e subvencionimit nuk mbështesin fermerët për të mbjellë lloje me rritje të shpejtë.

Fermerët ngadonjëherë janë skeptikë për të investuar për të ardhmë.

Trainimet për ngritjen e kapaciteteve janë të nevojshme.

7. Zhvillimi i Agropylltarisë

Agropylltaria është një sistem ku drurët dhe produktet bujqësore kombinohen dhe zhvillohen sëbashku në të njëjtën tokë. Në këtë sistem një mundësi për ta zhvilluar është mbjellja dhe shtimi i llojeve me rritje të shpejtë. Rritja dhe zhvillimi i plantacioneve me lloje me rritje të shpejtë si plep, shëlg etj shikohet si një mënyrë për përballuar brenda një periudhe të shkurtër kufizimet e moratoriumit dhe gjëndjes së dobët të pyjeve të vendit tonë. Kombinimi i plepit ose shëlgut me kulturat bujqësore krijojnë kombinim shumë të mirë të agropylltarisë. Nga ana tjetër përdorimi gardheve ose brezave mbrojtës japin dru zjarri dhe mbrojnë produktet bujqësore nga erërat. Kjo do të kontribuojë edhe në plotësimin e nevojave të komunitetit me biomasë për ngrohje e prodhuar nga energji e rinovueshme.



Për të zhvilluar këtë sistem CNVP këshilloi fermerët për të kombinuar plantacione bujqësore me lloje pyjore, për më tepër në një situatë shumë të keqe të pyjeve. Për këtë qëllim mund të zhfrytëzohen anët e rrugëve, kanalet ose tokave bujqësore duke krijuar breza pyjore që mbrojnë tokat bujqësore nga erërat, përmirësojnë mjedisin, sigurojnë material drusor etj. duke zhvilluar sistemin e agropylltarisë. Sistemet e agropylltairsë duhet të marë zhvillim më të madh në të ardhmen. Mësimet e fituara dhe praktikatat e mira janë dokumentuar dhe shpërndarë nga CNVP, dhe mund të përdoren për lobim dhe avokaci për të përmirësuar mjedisin rregullator e ligjor.

8. Aspekte të menaxhimit të pyjeve e kullotave integrohen në programin e edukimit për nxënësit.

Ka një boshllëk në vëmendjen ndaj çështjeve të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave në shkolla. Për të adresuar më mirë këtë çështje CNVP analizo boshllëqet në programin e edukimit në programet e shkollës dhe zhvilloi një metodologji për edukimin e nxënësve me njohuri për pyjet e kullotat. Bazuar në metodologjinë e hartuar CNVP përgatiti dhe publikoi një manual me material dhe ushtrime për nxënësit e shkollave. Manuali i Edukimit Mjedisor për Pyjet pati për qëllimin edukimin e nxënësve me njohuritë mbi pyjet, ekosistemet pyjore, ndërveprimin mes aktiviteteve njerëzore dhe pyjeve, mbrojtjen e ekosistemeve pyjore etj. Manuali i adresohet në rradhë të parë, mësuesve dhe nxënësve të shkollave 9-vjeçare (me fokus specifik klasën e 8 dhe 9), por ai mund të përdoret edhe nga organizata, institucione apo edhe individë që punojnë në fushën e edukimit mjedisor, në përgjithësi, dhe të pyjeve në veçanti.

Ky manual shërbeu për ngritjen e kapaciteteve të mësuesve për të përmirësuar dhe shpërndarë njohuritë mbi edukimin mjedisor dhe më konkretisht pyjet. Programi I edukimit u shoqërua me ushtrime të ndryshme dhe lojra për tu bërë më tërheqës për nxënësit. Ky program edukimi nuk adreson të gjitha

boshllëqet që mund të jenë në shkolla por jep informacion shtesë për të kuptuar dhe ndërgjegjësuar mbi pyjet dhe aspektet që lidhen me të. Programi i edukimit ndoqi këto hapa:

- Identifikimi i boshllëqeve dhe dhënia e sugjerimeve për programin në shkolla.
- Zhvillimi i metodologjisë për edukimin pyjor në shkollat 9 vjecare.
- Zhvillimi dhe zbatimi i një programi praktik gjysëm ditor me aktivitet ekstra kurrikular bazuar në manualin e përgatitur.

Aktiviteti i edukimit filloi me diskutime dhe takime reflektuese me mësuesit mbi kurrikulen shkollore për të zhvilluar program edukimi specifik duke marrë në konsideratë nivelin e njohurive për nxënësit e targetuar.



Programi pati tema specifike për edukimin pyjor për zhvillimin e qëndrueshëm gjithmonë brenda programit të biologjisë dhe mjedisit në shkolla të fokusuar në rëndësinë e pyjeve për mjedisin vecanërisht mbi rolin, përdorimin dhe rëndësinë e pyjeve. Konteksti lokal i infrastrukruës/llogjistikës rurale, gjendja e pyjeve, sektori pyjor dhe mjedisi në Shqipëri u reflektuan dhe u morën në konsideratë për të drejtuar aktivitetet në kushtet reale. Për më tepër u morën në konsideratë kapacitetet lokale për trainer/lehtësues sipas aktiviteteve të zgjedhura. Mesazhi kryesor i dhënë gjatë aktivitetit gjysëm ditor ishte si të frymzonte nxënësit në mënyrë që ata të pëlqenin një ditë mjedisore përmes marrjes së njohurive mbi çështjet e adresuara. Aktivitetet e edukimit ju adresuan zhvillimit të qëndrueshëm, rëndësisë së pyjeve, eko-turizmit, menaxhimit të kullotave, rëndësisë së pyjeve etj dhe si njeriu duhet të jetojë në harmoni me natyrën. Këto aktivitete ndihmuan nxënësit të mësojnë rreth pyjeve e mjedisit dhe ti pëlqejnë ato. Nxënësit vizituan zona pyjore dhe zhvilluan aktivitete mjedisore e pyjore si pjesë përbërëse e edukimit të tyre mjedisor. Mësimet edukative ishin të hapura me pyetje dhe diskutime midis nxënësve mbi eksperiencat e tyre, çfarë ata pëlqejnë, çfarë shikojnë të vështirë dhe çfarë ata do të dëshironin të bëhesh më mirë në të ardhmen. Si

mësuesit edhe nxënësit e vlerësuan programin dhe dëshironin që këto lloj aktivitete të ishin të shpeshta edhe në të ardhmen.



Edukimi mjedisor, veçanërisht për nxënësit dhe të rinjtë, ndihmoi në krijimin e një raporti të ri me mjedisin dhe natyrën. Nxënësit patën mundësinë të kontribuojnë individualisht në ruajtjen e mjedisit, dhe të vetë natyrës. Eksperiencat dëshmuuan se veprimtaritë jashtëshkollore në mjedisin pyjor japin rezultate në drejtim të menaxhimit dhe mbrojtjes së pyjeve, zhvillimit të ekosistemeve pyjore, ndërkohë që, gjatë realizimit të aktiviteteve ju kushtua vëmendje edhe argëtimit përmes procesit të të mësuarit dinamik.

Edukimi pyjor e mjedisor nuk pati për qëllim që të bëjë kritikën ndaj Kurrikulës Shkollore, dhe as tentoi të bëjë identifikimin e mangësive të saj. Përkundrazi, synimi ka qënë që vetë Manuali, së bashku me informacionin që përmban, aktivitetet e propozuara dhe procesin e realizimit të tyre, të plotësojë dhe/ose shtojë e pasurojë rast pas rasti, informacionin, aktivitetet dhe metodat e aplikimit të lëndës specifike “Biologjia dhe Edukata Shëndetësore”, e cila është pjesë e programit mësimor-edukativ në shkollë.



Programi i edukimit mjedisor përfshirë dhe Manualin nuk përbën një kurrikulë të plotë dhe as mbulon të gjithë aspektet e ndryshme që duhen marrë në konsideratë dhe trajtuar në nivelet e sistemit mësimor-edukativ në vendin tonë, veçanërisht në lëndën e Biologjisë. Por ai, nëpërmjet aktiviteteve që përmban

i pajis nxënësit me njohuri e përvojë për një pjesë të vogël të mjedisit, brenda ekosistemit pyjor. Këto pjesë të vogla të njohurive dhe përvojës formojnë gradualisht mozaikun e madh të të kuptuarit të mjedisit pyjor në përgjithësi dhe të aspekteve të veçanta që lidhen me të, përfshirë habitatet pyjore, përbërjen dhe shtresat e pyllit, zinxhirin ushqimor, shfrytëzimin e pyllit nga njeriu, produktet e pyllit, ndërvartësitë dhe nishet, mbrojtjen e pyjeve, etj. Programi gjithashtu ndihmoi mësuesit të përmirësojnë edukimin mjedisor në shkolla dhe të ndajnë eksperiencat e mira midis tyre.

Si një program i suksesëshëm dhe i pranueshëm si për nxënësit dhe mësuesit, ai mund të shtrihet në shkolla të tjera të Shqipërisë.

Aktivitetet e edukimit kombinuan eskursionet në terren me ushtrime për të testuar nxënësit mbi pyjet, mjedisin natyror, shqetësimet dhe kërcënimet ndaj pyjeve dhe banorëve të tyre.

Nxënësit ishin aktivë dhe pëlqyen e vlerësuan programin sepse ai ishte interesant, konkret, plotësues dhe ndryshe nga programi i shkollës. Në disa raste programi i edukimit u shoqërua me mbjellje fidansh përreth territorit të shkollës duke rritur interesin dhe përfshirjen e nxënësve.



Rezultatet

Përmirësohet besimi i mësuesve të bashkëpunojnë dhe punojnë sëbashku me aktorë të tjerë për edukimin mjedisor.

Përmirëohen njohuritë e nxënësve për pyjet dhe mjedisin.

Merret informacion shtesë mbi pyjet si nga mësuesit ashtu edhe dhe nxënësit.

Rriten kapacitetet e mësuesve për të zbatuar programe që lidhen me edukimin pyjor në shkolla.

Mësimet e nxjerra

Kombinimi i temave të edukimit me ushtrimeve dhe lojra edukimi rrit interesin e nxënësve.

Para fillimit të një programi edukimi është mirë të formulohet dhe të bihet dakort me drjetoritë arsimore nëpërmjet një marrëveshjeje që në fillim të vitit shkollor.

Ekspierencat dhe praktikat e këtij projekti mund të përdoren për zhvillim të mëtejshëm të manualit dhe zbatimit të tij në shkolla si një material shtesë mbi mjedisin.

Mësuesit nuk kanë kohë të zhvillojnë një program edukimi shtesë dhe krijimi i këtyre programeve krijon mundësi për mësuesit që të rrisin njohuritë për edukimin mjedisor.


Ky program nuk mbulon të gjitha boshllëqet por jep një kuptim të mëtejshëm dhe ndërgjegjëson nxënësit me çështje që lidhen me pyjet.

9. ENGLISH SUMMARY

STRENGTHENING MULTI-OBJECTIVES FOREST MANAGEMENT APPROACHES

Albania has 1,052,252 ha of forest area from which 379,396 ha of high forest; 295,440 of coppice and 377,416 ha of shrubs. Albanian forests were destroyed a lot during the last decades because of over logging, illegal cuttings, but also of the economic and political changes which created opportunities for illegal timber trading. Today the country market cannot supply the demands for wood material, especially firewood. On the other hand traditional users of forest areas have been trying to protect forests near their villages and houses which traditionally were used by their families. The process to create communal forest started 20 years ago in Albania to improve the situation and support the traditional users of forest and pasture areas but in the last years the forest and pasture areas changed the ownership again. Today about 80% of forest areas are in ownership of Municipality. The reform in forestry dismissed Forest Service creating new forest structures inside Municipalities. The new measures in forest legislation provided more authorities and responsibilities to Municipalities. This process created also better opportunities for forest and pasture users. Today wood biomass for energy is reduced. Compared with 27% in 1990 today wood biomass contributes 10% of the total energy sources. This reduction has reduced the pressure on forest area for firewood but the needs for fire wood are still sometimes more than the average annual growth, which has an impact in normal development of forests. Albania Government approved the moratorium law that prohibits logging activities aiming to improve the forest situation. However, the situation cannot be improved with restriction measures unless they are not accompanied: a) with other intervention to improve forests and reduce the pressure; b) by promoting other alternatives for heating; c) reforms for forest management and administration; and d) more rights for communities that use the forest areas.

FLED among others developed and tested multi objectives approaches of forest management to improve the situation. These approaches are related with rural families and high need for firewood. They have the ownership or use traditional forest areas creating family forest as a forest management practice to fulfil their needs with firewood and other wood materials. CNVP



has been supporting this model since the beginning of the project to improve, develop and replicate appropriate forest management practices to develop family forest model. This model is used also as demonstration sites and feed in to capacity building activities such as training, module development and sharing & learning. Many families in targeted areas and broader followed the family forest model and CNVP continued and stimulated stakeholder's involvement in discussions, sharing of experiences, knowledge brokering and evaluation of family forest model. CNVP supported also targeted area in south Albania, where pastures play a key role in rural development, to go further with pasture management by promoting improved pasture management. FLED provided information and developed knowledge on: classification and description of pastures, assessment of pasture biomass and grazing capacity, improving pastures quality and infrastructure such as water-points for livestock.

This program promoted renewable energy from wood biomass too, as a means of resources for alternative energy in Albania by using wood residues for energy production. The program increased awareness and built capacities of relevant stakeholders to be involved in the process. FLED supported also the community to improve management of forest including wood biomass for renewable energy by introducing fast growing species in small scale or creating agro forestry system. It revived a previous tradition by planting poplars along channels, rivers, roads or the edges of agricultural lands based on the previous tradition of wind breaks.

There is also gap on sustainable forest management practices in school programs. CNVP analysed the gaps in the current educational programme, and developed a methodology for forest and pasture management to integrate into education program. It was designed and printed an exercise-led manual for school children and expanded the education activities in targeted areas. This education programme built the capacity of school teachers/facilitators and improved the delivery of environmental education programmes, including the use of exercises and games that are linked to the environment, forests, pasture management and community concerns. A half day extra-curricula activity was developed and implemented and associated with exercises linked to the environmental/biology programme of targeted schools.

CNVP është aktive në rajonin e Ballkanit. Ka fokus kryesor menaxhimit të burimeve natyrore, Pyjeve, zhvillimit agro-rural dhe energjinë e rinovueshme gjithashtu dhe ndikimin e ndryshimeve klimatike në mjedis.

Si organizatë e shoqërisë civile, CNVP njihet në rang ndërkombëtar si letësuese për të:

- Fuqizuar kapacitetet e komunitetit për arritjen e qëllimit të zhvillimit lokal;
- Maksimizuar prodhimin dhe potencialet e shërbimeve në zonat rurale përmes menaxhimit të qëndrueshem dhe të kontrolluar lokalisht të burimeve natyrore;
- Promovuar përdorimin e burimeve natyrore për përmirësimin e zhvillimit socio-ekonomik dhe jetesën në zonat rurale dhe;
- Ruajtur biodiversitetin e burimeve natyrore ndaj ndryshimeve serioze klimatike dhe mjedisore.

Vlerat themelore të CNVP

- **E gjelbër** – ndërhyrje për të ndërtuar një mjedis ekonomik me të gjelber ndaj proceseve të vazhdueshme të ndryshimeve klimatike.
- **E pastër** – promovimi i energjisë së rinovueshme dhe menaxhim i përmirësuar i mbetjeve shtëpiake/industrial.
- **E kudogjendur** – operon në Rajonin e Ballkanit dhe synon hapësirën Fqinje Europiane.
- **Produktive** – përmirëson vazhdimisht dhe sistematikisht efencën e ofrimit të shërbimeve.

Connecting Natural Values & People
Zayed Centre Floor 7, Tirana e Re PO Box 8303
Tirana, Albania,
Tel +355 4 222 9642, +355 4 2229551
www.cnvp-eu.org

Project managed by:



Financed by:

